



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
REKTORATI

Nr. 151 prot

Durrës, më 24.01.2020


**VENDIM**

Nr. 1, datë 29.01.2020.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 i MASR, VKM nr. 879, datë 18.12.2019, Rektorati në mbledhjen e tij të zgjeruar të datës 24.01.2020,

**VENDOSI:**

1. Ngarkimin e Dekanëve të fakulteteve për zbatimin e Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020, të shkresës nr. 315/1 datë 15.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të merren masa për zbatimin e afateve dhe procedurave që parashikohen në këtë udhëzim.
2. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, në marrjen e masave për të depozituar në Protokollin e Institucionit draft orarin për semestrin e dytë në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, deri me datë 31.01.2020.
3. Ngarkimin e Dekanëve të fakulteteve brënda datës 31.01.2020 të depozitojnë kriteret për vitin akademik 2021-2022, kuotat për vitin akademik 2020-2021.
4. Kalimin për miratim të shkresës Nr. 07 prot, datë 07.01.2020 të Dekanit të Shkencave Politike Juridike dhe ngarkimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore e Juridike për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.



5. Ngarkimin e Dekanëve të fakulteteve për përcjelljen e një perfaqësuesi të fakultetit për hartimin e rregullores së organizimit të zgjedhjeve të Institucionit.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi
  - Zv.Rektorët
  - Dekanët e Fakulteteve
  - Drejtoria e Administrimit të Shërbimeve Akademike
  - Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Juridike
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**R E K T O R**

**Prof.Dr. Ksenela Sotirofski**

